



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 21, date 26/04/2004

“PER
FINANCIMIN E SHPENZIMEVE TE VARRIMIT TE INVALIDEVE TE LUFTES
Z. HALIL MANÇELLARI, Z. TEFIK XHEMOLLARI, Z. SHEFQET MUÇO, Z.
ISMAIL HOXHA, Z. PIRO BURNAZI, Z. KOSTA THEOHARI, Z. XHAFER
QORDJA, Z. PANDELI PERMETI, Z. ABEDIN POLOSKA, Z. MUSTAFA
XHUNGA”.

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.26/04/2004, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore “Për financimin e shpenzimeve të varrimit të Invalidëve të Luftës Z. Halil MANÇELLARI, Z. Tefik XHEMOLLARI, Z. Shefqet MUÇO, Z. Ismail HOXHA Z. Piro BURNAZI, Z. Kosta THEOHARI, Z. Xhafer QORDJA, Z. Pandeli PËRMETI, Z. Abedin POLOSKA, Z. Mustafa XHUNGA”, mbështetur në Ligjin 8652, datë 31/07/2001 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 19, (pika 9), neni 44, (pika c), në Ligjin 7663, datë 20/01/1993, “Për Statusin e Invalidit të Luftës” neni 7, (paragrafi 2), Vendimit të Këshillit Bashkiak **Nr. 16, datë 10/03/2004 “Për Miratimin e Realizimit të Buxhetit të vitit 2003 dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2004”** dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I;

I. Të financohen shpenzimet e varrimit të Invalidëve të Luftës sipas kufirit limit të përcaktuar në pikën 1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 94, dt. 20/12/2002 “Për përcaktimin e kriterëve dhe financimin e shpenzimeve të varrimit të invalidëve të luftës” si më poshtë vijon:

1. Halil	MANÇELLARI	30.000 lekë
2. Tefik	XHEMOLLARI	30.000 lekë
3. Shefqet	MUÇO	30.000 lekë
4. Ismail	HOXHA	30.000 lekë
5. Abedin	POLOSKA	30.000 lekë
6. Piro	BURNAZI	30.000 lekë
7. Kosta	THEOHARI	30.000 lekë
8. Xhafer	QORDJA	30.000 lekë
9. Pandeli	PËRMETI	30.000 lekë
10. Mustafa	XHUNGA	30.000 lekë

II. Shuma prej 300.000 lekësh, të përballohen nga zëri “Shpenzime varrimi për veteranët”, nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës.

III. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar, për zbatimin e këtij Vendimi.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi dhjetë ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI